

## Kalendari i temave mujore

Jemi të lumtur të ndajmë me ju kalendarin e temave mujore të revistës "Psika", ku synojmë që nëpërmjet tij të ofrojmë një gamë të gjerë perspektivash dhe idesh nga fusha e shëndetit mendor dhe psikologjisë.

Afatet për dorëzim të krijimeve apo shkrimeve për secilën temë janë si në vijim:

### **Muaji: Shkurt**

**Tema:** Eksplorimi i çrregullimeve të shëndetit mendor (Pjesa 1)

Përgjatë muajit shkurt, temat do të fokusohen në njohjen dhe kuptimin e çrregullimeve më të shpeshta të shëndetit mendor si depresioni, ankthi, dhe problemet tjera emocionale të cilat ndikojnë në shëndetin tonë mendor.

**Afati i fundit për dorëzim të shkrimeve:** 22 Janar

### **Muaji: Mars**

**Tema:** Eksplorimi i Çrregullimeve të Shëndetit Mendor (Pjesa 2)

Vazhdim i temës mbi shëndetin mendor, muaji mars do të përqëndrohet në kuptimin më të thellë të çrregullimeve si skizofrenia, çrregullimi bipolar dhe çështjeve të ndërlidhura me to.

**Afati i fundit për dorëzim:** 22 Shkurt

### **Muaji: Prill**

**Tema:** Zhvillimi psikologjik gjatë gjithë jetës:

Përgjatë muajit Prill, temat synojnë të përmbledhin kuptimin e proceseve të zhvillimit psikologjik nga fëmijëria e tutje, duke përshkruar fazat kryesore dhe sfidat që shoqërojnë secilën prej tyre, me fokus në shëndetin mendor.

**Afati i fundit për dorëzim:** 10 Mars

## **Muaji: Maj**

**Tema:** Ndërhyrjet dhe shërbimet e shëndetit mendor

Përgjatë muajit maj, synohet që të shqyrtohen metodat dhe shërbimet në trajtimin e sfidave të shëndetit mendor.

***Afati i fundit për dorëzim:*** 10 Prill

## **Muaji: Qershor**

**Tema:** Ndërsektorialiteti dhe Shëndeti Mendor

Përgjatë muajit qershor, temat do të synojnë të shqyrtojnë lidhjen midis identiteteve (gjinore, etnike, socio-ekonomike) dhe përvojës së shëndetit mendor, duke theksuar rëndësinë e kulturës dhe kontekstit social.

***Afati i fundit për dorëzim:*** 10 Maj

## **Muaji: Korrik**

**Tema:** Forenzika, Ligji dhe Siguria Publike

Përgjatë muajit korrik, temat do të synojnë të adresojnë lidhjen midis shëndetit mendor, drejtësisë, dhe sigurisë publike, duke shqyrtuar ndërthurjen e fushave të shëndetit dhe ligjit në kontekstin e sigurisë shoqërore.

***Afati i fundit për dorëzim:*** 10 Qershor